

BULETINI 2025



KOMUNA E LIPJANIT



TETOR

Tetori – Muaji i Mundësive të Barabarta



Në Bibliotekën e Qytetit në Lipjan, u zhvillua një aktivitet i veçantë në kuadër të Muajit të Mundësive të Barabarta, i cili synon të rrisë vetëdijen për personat me nevoja të veçanta dhe të nxisë pjesëmarrjen e tyre aktive në jetën sociale dhe institucionale.

Me këtë rast, nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, theksoi rëndësinë e këtij aktiviteti dhe potencoi se Komuna e Lipjanit mbetet e përkushtuar për të siguruar mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët dhe për të krijuar një shoqëri gjithëpërfshirëse. Ky aktivitet është një dëshmi e qartë se respekti, mbështetja dhe përfshirja nuk janë vetëm fjalë, por vlera që ne i promovojmë çdo ditë.

Ky aktivitet u realizua me mbështetjen e Komunës së Lipjanit dhe organizimin e përbashkët të OJQ-ve Handikos dhe OMPAK, duke dëshmuar angazhimin e tyre të vazhdueshëm për integrimin dhe fuqizimin e personave me nevoja të veçanta.

Ka filluar përgatitja e terrenit për ndërtimin e lagjes së re për familjet e kategorive të dala nga lufta



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorët dhe përfaqësuesit e kompanisë ndërtuese, ka marrë pjesë në fillimin e përgatitjes së terrenit, ku do të ndërtohet lagja e re banesore, e cila do t'u dedikohet familjeve të kategorive të dala nga lufta.

Kryetari Ahmeti theksoi se ky projekt i rëndësishëm synon të ofrojë strehim të denjë dhe mundësi të reja për familjet e dëshmorëve, veteranëve dhe invalidëve të UÇK-së, duke u krijuar atyre kushte të përshtatshme për jetesë dhe siguri për të ardhmen.

“Po ndërtojmë një lagje të re, të bukur dhe me kushte moderne, e cila do të ofrojë strehim të denjë dhe mundësi të reja për familjet e dëshmorëve, veteranëve dhe invalidëve të UÇK-së. Kjo lagje do t'i japë qytetit një pamje më të mirë, por mbi të gjitha do të sjellë qetësi dhe siguri për shumë familje. Ky është vetëm një hap tjetër në rrugën tonë të përkushtimit dhe punës konkrete”, tha Kryetari z. Imri Ahmeti.

Lagja e re do të shtrihet në një sipërfaqe prej rreth 45,000 m², me rreth 100 njësi banesore, të cilat do t'u jepen falas për shfrytëzim afatgjatë përfituesve.

Ky projekt shënon një tjetër hap të rëndësishëm në përpjekjet e Komunës së Lipjanit për të krijuar kushte më të mira jetese dhe për të përmbushur zotimet ndaj atyre që kanë dhënë shumë për lirinë e vendit.

Drejtuar nga Kryetari i Komunës, Imri Ahmeti, është mbajtur mbledhja konsultative e Bordit të Drejtorëve



Në këtë takim u diskutuan shumë çështje që kanë të bëjnë me realizimin e projekteve të planifikuara për këtë vit dhe mbarëvajtjen e tyre, për dinamikën e shpenzimit të buxhetit dhe realizimin e të hyrave vetanake sipas planifikimit buxhetor.

Kryetari z. Imri Ahmeti ka kërkuar nga drejtorët angazhim në përmbushjen e objektivave siç janë paraparë deri në përmbyllje të buxhetit, por fokus të veçantë të kenë edhe ndërtimin e planit për vitin e ardhshëm.

Po ashtu gjatë këtij takimi, Kryetari z. Imri Ahmeti ka kërkuar nga drejtorët angazhim maksimal në realizimin e punëve dhe shërbimeve komunale. Ndërsa, drejtorët e drejtorive kanë raportuar lidhur me punët dhe sfidat gjatë realizimit të punëve dhe objektivave të tyre.

Kryetari Imri Ahmeti ka pritur përfaqësues të lartë nga Organizata e Qatar Charity në shtetin e Katarit



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti së bashku me drejtorin e Bujqësisë z. Rexhep Rexhepin, kanë pritur përfaqësues të lartë nga Organizata e Qatar Charity në shtetin e Katarit të prirë nga z. Ali Karadagi dhe z. Ahmed Fahru të shoqëruar nga z. Ahmad Al Ashal drejtor Qatar Charity zyra në Prishtinë.

Gjatë takimit është diskutuar mbështetja dhe donacionet e ndryshme nga organizata Qatar Charity për qytetarët e komunës së Lipjanit përmes shpërndarjes së granteve të vogla nga sektori i bujqësisë për familjet me kushte të rënda ekonomike, me qëllim të fuqizimit ekonomik të këtyre familjeve.

Kryetari Imri Ahmeti ka falënderuar përfaqësuesin e organizatës Qatar Charity Ali Karadagi, për gatishmërinë që ka treguar shteti i Katarit që një kohë për ti ndihmuar qytetarët e Komunës së Lipjanit të cilët kanë pasur nevojë për ujë të pijes si dhe tani me projektin tjetër për qytetarët të cilët janë me gjendje jo të mirë ekonomike përmes granteve të vogla ndihmë kjo e cila për Komunën e Lipjanit është shumë e mirëseardhur.

Nga ana tjetër, Ali Karadagi, ka falënderuar Kryetarin Imri Ahmeti për bashkëpunimin e mirë dhe korrekt që ka treguar deri më tani, duke e uruar në të njëjten kohë Kryetarin Ahmeti për mandatin e katërt.

Ndryshe, Komuna e Lipjanit viteve të fundit ka bashkëpunuar ngusht me organizatën Qatar Charity, bashkëpunim ky i cili u kumtua edhe sot që do vazhdojë edhe më thellë në të ardhmen.

Kryetari Imri Ahmeti së bashku me përfaqësuesit nga Organizata e Qatar Charity kanë takuar edhe disa nga përfituesit e këtyre donacioneve.



Komuna e Lipjanit – Zyra për informim



<https://lipjan.rks-gov.net/>



infokomuna.lipjan@rks-gov.net



0 800 14 000 / 038 200 41 508